

VENDIM
Nr.79, datë 21.12.2007

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “GSA” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3, nenit 13 pika 1 germa “dh”, si dhe nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenet 14, 16 të “Rregullores së procedurave të licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e importit të energjisë elektrike, për periudhën nga 27.1.2008 deri më 26.1.2011.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë me shkrim aplikuesin (Shoqërinë “GSA” sh.p.k.).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta